

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A.B. nga Gj., për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A.B., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë P.nr.45/2012 datë 16.09.2016, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr.1379/2016 datë 18.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.05.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit A.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë P.nr.45/2012 datë 16.09.2016, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1379/2016 datë 18.10.2017.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.45/2012 dt. 16.09.2016, të dënuarin A.B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda kohës së verifikimit në afat prej 2 (dy) vite nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. I dënuari është

detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1379/2016 datë 18.10.2017 e ka refuzuar ankesën e të dënuarit A.B., ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A.B. av. M.S., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.nr.12/18 datë 02.02.2018, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të kundërligjshme të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal të cilat shkelje janë elaboruar edhe në ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Dispozitivat e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, janë të pakuptueshëm, në masë të madhe kundërthënëse me brendinë e tyre dhe arsyet e aktgjykimeve. Në aktgjykime nuk janë paraqitur arsyet mbi faktet vendimtare dhe ato që janë paraqitur janë kundërthënëse në masë të konsiderueshme, për faktet vendimtare ka kundërthënie ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe vet këtyre shkresave dhe procesverbaleve. Po ashtu në kërkesë theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara bazohen vetëm në deklaratimet e të dëmtuarës dhe të një njoftimi të lëshuar nga gjykata e Pejës, se Gjykata Themelore në Pejë disa herë ka potencuar fjalën “aktgjykim i falsifikuar P.nr.297/97”, dhe asnjëherë nuk ka bërë ekzaminimin e atij aktgjykimi se i njëjti është vërtetë i falsifikuar apo jo. Si pasojë e këtyre shkeljeve qenësore theksohet se ka ardhur

deri te shkelja e ligjit penal në dëm të dënuarit, sepse në rastin konkret është gjykuar për një veprë penale që gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar më asnjë provë, a në realitet gjykata në arsyetimin e vet thotë se aktgjykimi është i falsifikuar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12. të KPPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal janë të pabazuara. Siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimi i shkallës së parë i vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme për fakte vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet ku është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështje penalo-juridike, e sidomos me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Nuk ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit e as ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe vet këtyre shkresave dhe procesverbaleve ashtu siç pretendohet në kërkesë. Nuk qëndron pretendimi i shprehur në kërkesë se gjykata e shkallës së parë ka vendosur vetëm në bazë të deklarimeve të të dëmtuarës dhe në një njoftim të lëshuar nga gjykata e Pejës, për faktin se gjendjen faktike në këtë çështje penalo-juridike, gjykata e ka vërtetuar pas administrimit të provave materiale dhe jo materiale, (shih pasusi 2 faqe 3-4 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë) siç ndër të tjera theksohen: kontrata e dhurimit e lidhur midis dhuratëdhënësit A. B. dhe dhuratëmarrësit KBI "E...." të datës 31.07.1963, aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë me P.nr. 297/97, për prishjen e kurorës në mes M. dhe M1.M., aktgjykimi i falsifikuar me po të njëjtin numër P.nr.297/97 të datës 11.02.1998, lëshuar nga Gjykata Komunale po ashtu në Pejë, në emër të A.B., historiati i pronës për parcelën kadastrale nr.4.../2, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Gj. me nr.9...-/2. i datës 02.11.2011, aktvendimi nr.424/11 datë 12.05.2011, i zyrës kadastrale në Gj. me nr.424/11 datë 12.05.2011, lëshuar në emër të kërkuesit A.B. për bartjen e pronësisë në regjistrin kadastral nga baza juridike e aktgjykimit C.nr.297/97 datë 11.02.98, për parcelën kadastrale nr.4.../2; aktvendimi i zyrës kadastrale në Gj. me nr.567/11 datë 16.03.2011, lëshuar në emër të kërkuesit B.L., për bartjen e pronësisë në regjistrin kadastral nga baza juridike e kontratës së shitblerjes Vr.nr. 2657/11 dt. 13.06.2011, për parcelën kadastrale nr.4.../8; aktvendimi i zyrës kadastrale në Gj. me nr.1074/11 dt. 17.10.2011, lëshuar në emër të kërkuesit D. (A.) H. për bartjen e pronësisë në regjistrin

kadastral nga baza juridike e kontratës së shitblerjes Vr.nr.5862/11 dt. 12.10.2011, për parcelën kadastrale nr.4../8 , deklarata e përfaqësueses së autorizuar e të dëmtuarës AKP-ja A.A. dhe e dëshmitarit B.L. dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 17.03.2016 etj. Gjithashtu nuk qëndron pretendimi i mbrojtësit të dënuarit se gjykata thirret dhe bazohet në një aktgjykim të falsifikuar me P.nr.297/97, pa u ekzaminuar me ekspertizë gjyqësore se vërtetë kemi të bëjmë me aktgjykim të falsifikuar, për faktin se gjykata e ka vërtetuar këtë fakt me deklaratën e përfaqësueses së të dëmtuarës AKP-ja, me seli në Pejë, në prezencën e kryetarit të Gjykatës Komunale në Pejë, ku është shikuar lënda P.nr.297/97 dhe është vërejtur se me këtë numër në këtë lëndë objekt shqyrtimi ka qenë një çështje tjetër e natyrës civile - shkurorëzimi i martesës me marrëveshje në mes palëve në procedurë M.e M1 M. Nga të theksuarat si më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike në këtë çështje penale në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPP-së, me që gjykata provat i ka vlerësuar në pajtim me këtë dispozite duke i paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të paprovuara duke dhënë edhe vlerësimin dhe konkludim për to.

Gjykata Supreme vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa pretendimi i mbrojtësit se me aktgjykimet e lartëcekura është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, po ashtu nuk qëndron, për faktin se veprimi i kryerjes qëndron në shtyrjen e organit kompetent për ta legalizuar një përmbajtje të pavërtetë, gjë që nënkupton sjelljen në lajthim të organit kompetent përkitazi me saktësinë e fakteve të cilat i vërteton organi.

Nga arsyet e dhëna më sipër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

PML.nr.19/2018, më datë 07.05.2018

Procesmbajtëse,
Minire Xhambazi

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa

